

VENDIM
Nr.502, datë 24.11.1997

**PËR PAGIMIN E SHUMAVE DHE DIFERENCAVE TË PENSIONEVE PËR PERIUDHË TË
KALUAR PËR TË PËRNDJEKURIT POLITIKË**

Në zbatim të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” dhe të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 6.3.1993 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.2, datë 4.1.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të fillojë likuidimi përfundimtar i shumave të pensioneve për periudhë të kaluar dhe i diferencave të pensioneve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

2. Pagesat e pensioneve dhe diferencave të pensioneve për të përndjekurit politikë në shumën 167.3 milionë lekë do të përballohen:

- Në shumën 140 milionë lekë me fondet e akorduara për këtë qëllim nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1997.

- Në shumën 27.3 milionë lekë me fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zërin “transferime nga Buxheti i Shtetit”.

3. Radha e likuidimit përfundimtar të pensioneve dhe diferencave të pensioneve do të jetë sipas radhës së tërheqjes së kësteve të mëparshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano